PROCESVERBAL
nga seanca e 36-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele të mbajtur me datë 27.10.2026

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:

- **Kryetari i Këshillit:** Mr. Sasho Stefanovski
- **Zëvendëse e kryetarit të Këshillit:** Mr. Zirjeta Jajaga
- **Anëtarët e Këshillit:** Afrona Vërzivolli, Cvetanka Mitrevska, mr. Gordana Majnova, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavllovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /.

Të pranishëm nga drejtuesit e Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Muhamer Beqiri, zëvendës i drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Emilija Janevska, Ivona Mufisheva, Maja Damevska dhe Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski hapi seancën e 36-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 7 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 21.10.2026.

2. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të ShTR TV DUE Nazmi ShPKNjP Gostivar, për shkelje të nenit 92, paragrafi (1) të LSHMAAV-së;

3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të ShTR TV DUE Nazmi ShPKNjP Gostivar, për shkelje të nenit 14 të LM-së

4. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të ShTR Spektra, Komuna Llabunishtë ShPKNjP.

5. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio Koçan FM ShPK Koçan.

6. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio Fortuna Violeta ShPKNjP Shkup.

7. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Mapedito-Radio Meff ShPKNjP Prilep.

8. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio Antena 5 ShPK Shkup.

9. Propozim-vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR Radio Kanal 77 ShPKNjP Shtip.

10. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 21.10.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2 dhe 3

Zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, Muhamer Beqiri, shpjegoi se kemi të bëjmë me mospërmbushje të detyrimit për transmetim së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedone, prandaj propozoi që ShTR TV Due Nazmi ShPKNjP Gostivar, t'i shqiptohet masë paralajmërim publik. Njëkohësisht, në lidhje me shkeljen e nenit 14 të Ligjit për Media, shpjegoi se bëhet fjalë për mospublikim impresium me të dhënat rreth programit në fund të programit të transmetuar.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, në mënyrë procedurale propozoi, përveç mbikëqyrjeve të rregullta, Agjencia t'i kushtojë vëmendje plotësuese rolit parandalues dhe edukativ në lidhje me transmetuesit. Ndërkohë, theksoi se shërbimet e Agjencisë janë në komunikim të vazhdueshëm me transmetuesit dhe u ofrojnë mbështetje në përmbushjen e detyrimeve ligjore, por vlerëson se do të ishte e dobishme në të ardhmen të organizohen takime dhe punëtori me transmetuesit lokalë, sipas rajoneve.

Në këto takime të diskutohet më në detaje për detyrimet ligjore, standardet teknike dhe parregullsitë më të shpeshta në punë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të transmetuesve dhe zvogëlimin e mundësisë për përsëritjen e mangësive të konstatuara.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Due Nazmi ShPKNjP Gostivar t'i shqiptohet masë paralajmërim publik, në pajtim me nenin 92, paragrafi (1) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Me këtë aktvendim, operatori detyrohet që në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), nr. 01-4241/1 të datës 01.10.2025, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat ligjore.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim, të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse transmetuesi ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtori dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin në faqen e internetit të Agjencisë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Due Nazmi ShPKNjP Gostivar, t'i shqiptoi masë paralajmërim publik, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Media. Me këtë Aktvendim, operatori detyrohet që në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), nr. 01-4241/1 të datës 01.10.2025, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat ligjore.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim, të kryejë mbikëqyrje kontrolli me qëllim përcaktimin nëse transmetuesi ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtori dhe Këshillit, ta publikojë Aktvendimin në faqen e internetit të Agjencisë.

Pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9

Zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, Muhamer Beqiri, shpjegoi se pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Rendit të ditës, i referohen vazhdimit të lejeve për transmetim televiziv dhe

radio të gjashtë transmetuesve. Meqënëse në periudhën e mëparshme, gjatë së cilës i posedonin lejet, tek asnjë nga transmetuesit nuk u konstatuan shkelje të Kodit Zgjedhor të konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe shkelje të dispozitave të veçanta të nenit 48 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, propozoi që të gjashtë transmetuesve t'u vazhdohet leja për transmetim televiziv dhe radio për periudhën e ardhshme nëntëvjeçare. Gjithashtu theksoi se, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me procedurë të njëjtë dhe të gjithë transmetuesit kanë përmbushur kushtet për vazhdimin e lejeve, nuk është e nevojshme çdo pikë të shpjegohet veçmas.

Anëtarja e Këshillit, mr. Gordana Majnova, vuri në dukje se nuk kishte vërejtje plotësuese, duke pasur parasysh se nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave relevante ligjore tek transmetuesit, ju uroi punë të suksesshme për nëntë vitet e ardhshme.

Kryetari i Këshillit, mr.Sasho Stefanovski, iu bashkua urimeve, duke u dëshiruar dëgjuesve dhe shikuesve sinjal dhe qasje cilësore.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive Spektra, komuna Llabunishtë ShPKNjP, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim televiziv e Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive Spektra, komuna Llabunishtë ShPKNjP, PA1 nr.08-56 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Koçani FM ShPK Koçan, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Koçani FM ShPK Koçan, PA1 nr.08-106 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Fortuna Violeta ShPKNjP Shkup, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Fortuna Violeta ShPKNjP Shkup, PA1 nr.08-82 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 7

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Mapedito-radio Meff ShPKNjP Prilep, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Mapedito-radio Meff ShPKNjP Prilep, PA1 nr.08-118 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Antena 5 ShPK Shkup, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Antena 5 ShPK Shkup, PA1 nr.08-63 datë 7.9.2023 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në faqen e internetit të Agjencisë dhe t'ia dorëzojë transmetuesit.

Votimi për pikën 9

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio Kanal 77 Shtip, me tekstin e propozuar. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio

Kanal 77 Shtip, PA1 nr.08-64 datë 07.09.2023, i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 05.01.2027 deri më 04.01.2036.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lertpërmendur do ta publikojë në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në faqen e internetit të Agjencisë dhe t’ia dorëzojë transmetuesit.

Pika 10

Në kuadër të pikës „Të ndryshme“, zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, i përgëzoi transmetuesit për vazhdimin e lejeve dhe u uroi suksese në punë, duke shpresuar se kontributi i tyre do të mundësojë transmetim mediatik më cilësor. Njëkohësisht, informoi se lejet në mënyrë soleme do t’u ndahen në ambientet e Agjencisë.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.

Përktheu: Antoneta Shabani